



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Qershor 2021

Nr: 414

V E N D I M

**PËR SHPËRNDARJEN E MANDATEVE MIDIS SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE
PËRCAKTIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU LEZHË PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25.04.2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 162 dhe 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për Kuvendin dhe për këshillat vendore, si dhe jep mandatet për çdo deputet, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 349, datë 4.05.2021 ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore Qarku Lezhë. Kundër këtij vendimit, brenda afateve ligjore, nuk u paraqitën kërkesa ankimore. Në përfundim të afatit të ankimit, Komisioneri në mbështetje të nenit 162, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, përlllogarit shpërndarjen e mandateve për Kuvendin.

Në bazë të nenit 162, pika 1, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t’u përfshirë në përlllogaritjen e shpërndarjes së mandateve janë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1.	Partia Socialiste e Shqipërisë	768.134	48,67%
2.	Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”	622.187	39,42%
3.	Lëvizja Socialiste për Integrim	107.538	6,81%
4.	Partia Socialdemokrate	35.475	2,25%



Rezultati për Qarkun Lezhë për subjektet zgjedhore, sipas vendimit nr. 349, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1	Partia Socialdemokrate	319	0,44%
2	Partia Balli Kombëtar	133	0,19%
3	Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare	349	0,49%
4	Partia Bindja Demokratike	284	0,40%
5	Koalicioni "Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët"	60	0,08%
6	Lëvizja Socialiste për Integrim	7.416	10,34%
7	Partia Nisma Thurje	544	0,76%
8	Partia Lëvizja e Re	363	0,51%
9	Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"	33.998	47,42%
10	Partia Aleanca Demokracia e Re	127	0,18%
11	Partia Lëvizja Për Ndryshim	440	0,61%
12	Partia Socialiste e Shqipërisë	27.269	38,03%
13	Iljaz Jashar Shehu	400	0,56%
	Totali i votave të vlefshme	71.702	100%

Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t'u përfshirë në përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve kanë fituar vota si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota
1	Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"	33.998
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	27.269
3	Lëvizja Socialiste për Integrim	7.416
4	Partia Socialdemokrate	319

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 7 (shtatë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore qarku Lezhë, në bazë të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 7, datë 11.12.2020.

Subjekti zgjedhor/ pjesëtuesit	1	2	3	4	5	6	7	Herësit
PD-AN	33998	16999	11333	8500	6800	5666	4857	
PS	27269	13635	9090	6817	5454	4545	3896	
LSI	7.416	3.708	2.472	1.854	1.483	1.236	1.059	
PSD	319	160	106	80	64	53	46	



Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore qarku Lezhë, pra 7. Nga kjo renditje marrim rezultatin si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Herësit
1	PD-AN	33998
2	PS	27269
3	PD-AN	16999
4	PS	13635
5	PD-AN	11333
6	PS	9090
7	PD-AN	8500

Në bazë të nenit 162, pika 5, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Sipas nenit 163, pika 1, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.

Shpërndarja e mandateve fillon me rend zbritës, në bazë të renditjes së tyre në listën shumëmemërore, duke filluar nga numri rendor një, si dhe numrit të votës parapëlqyese të secilit kandidat.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, sipas vendimit nr. 349, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PD-AN			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Mark	Pjetër	Marku	M	5.321
2	Agron	Nikolle	Gjekmarkaj	M	4.067
3	Lindita	Illir	Metaliaj	F	2.328
4	Kastriot	Pren	Piroli	M	9.374
5	Zef	Gjergj	Gjoka	M	1.310
6	Roza	Luigj	Hilaj	F	993
7	Gjovalin	Kol	Laska	M	1.044
8	Salvador	Pretash	Kaçaj	M	1.654
9	Elda	Artan	Hoti	F	2.733
Gjithsej					28.824

Sipas nenit 163, pika 3, të Kodit Zgjedhor, në fillim përfitojnë mandat kandidatët që kanë marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara nga subjekti në zonën zgjedhore. Në çdo rast, herësi nuk mund të jetë më shumë se 10 mijë vota.

Për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” herësi është 8.500. Kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 4 (katër) të mandateve të fituara nga ky subjekt, nuk ka dhe në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas vendimit nr. 349, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PS			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Lindita	Llesh	Nikolla	F	5.145
2	Eduard	Ndue	Ndreca	M	7.250
3	Shpresa	Ndue	Marnoj	F	3.171
4	Gentian	Mirash	Malotaj	M	5.052
5	Benard	Pal	Palaj	M	923
6	Eueda	Fatmir	Molla	F	989
7	Erjola	Llesh	Ndoci	F	402
8	Gjon	Pjetër	Ndoci	M	207
9	Lina	Nik	Guri	F	573
Gjithsej					23.712

Për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë herësi është 9.090. Kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 3 (tre) të mandateve të fituara nga ky subjekt, nuk ka dhe në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 162 dhe 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V E N D O S:

1. Të shpërndaj mandatet për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Lezhë, si më poshtë:
 - a) Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” 4 mandate
 - b) Partia Socialiste e Shqipërisë 3 mandate
2. Të shpall kandidatët fitues për deputetë për Qarkun Lezhë për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” , si më poshtë:



1	Mark	Pjetër	Marku	PD
2	Agron	Nikolle	Gjekmarkaj	PD
3	Lindita	Ilir	Metaliaj	PR
4	Kastriot	Pren	Piroli	PD

3. Të shpall kandidatët fitues për deputetë për Qarkun Lezhë për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, si më poshtë:

1	Lindita	Llesh	Nikolla
2	Eduard	Ndue	Ndreca
3	Shpresa	Ndue	Marnoj

4. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumëmemërore të subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, të cilët nuk kanë përfituar mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave, si më poshtë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
5	Elda	Artan	Hoti	F	2.733
6	Salvador	Pretash	Kaçaj	M	1.654
7	Zef	Gjergj	Gjoka	M	1.310
8	Gjovalin	Kol	Laska	M	1.044
9	Roza	Luigj	Hilaj	F	993

5. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumëmemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë të cilët nuk kanë përfituar mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave, si më poshtë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
4	Gentian	Mirash	Malotaj	M	5.052
5	Eueda	Fatmir	Molla	F	989
6	Benard	Pal	Palaj	M	923
7	Lina	Nik	Guri	F	573
8	Erjola	Llesh	Ndoci	F	402
9	Gjon	Pjetër	Ndoci	M	207

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

